



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 946/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muharrem Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Mitrovicë, paraqitur kundër subjekteve politike Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Mitrovicë për shkak të fillimit të fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve, në seancën e panelit të mbajtur me 21.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHEN poshtë si të palejuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega ne Mitrovicë

Arsyetim

PZAP, më datë 20.11.2013, ka pranuar ankesat: Anr. 946/2013, dhe Anr. 947/2013 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK), dega Mitrovicë, me të cilat pretendohet se:

- Në ankesën Anr. 946/2013 të PDK-së theksohet se kandidati për kryetar komune të Mitrovicës nga AKR dega në Mitrovicë Agim Bahtiri me datën 14.11.2013 në Qendrën e Kulturës “Rexhep Mitrovica” prej orës 12:00 ka mbajtur tubim pa siguruar leje paraprake nga organet kompetente dhe në tubim ka bërë fushatë elektorale para kohës së caktuar nga KQZ-ja për balotazh të datës 1 Dhjetor 2013. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotografi nga vendi i supozuar i ngjarjes.
- Në ankesën Anr. 947/2013, të PDK-së theksohet se me datën 17.11.2013 koalicioni AKR-LDK në Mitrovicë për zgjedhjet e balotazhit të 1 Dhjetorit kanë mbajtur tubime elektorale me banorët e tunelit të parë, Trepçës, Roshanit dhe Vllahisë edhe pse nuk është kohë e fushatës zgjedhore të caktuar nga KQZ-ja. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi disa fotografi nga vendi i supozuar i ngjarjes.

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pasi shqyrtoi lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:


Ankesat janë të palejuara

PZAP-i, duke u bazuar në dispozitat e nenit 33 të LZP-së, me të cilin ndalohen veprimet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ashtu siç parashihen në pikat a), b), c), d) të këtij neni, po ashtu me nenin 44 të LZP-së, 44.1 pikat a), b), c) ku përcaktohen të drejtat e subjekteve politike për veprimet e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, dhe meqenëse veprimet e pretenduara janë zhvilluar para datës së caktuar për fillimin e fushatës zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale që do të mbahen me 01.12.2013, PZAP-i duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore konstatoi se nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara, ngase me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së nuk është paraparë marrja e masave ndëshkimore për mbajtjen e tubimeve apo fillimin e fushatës zgjedhore para datës së caktuar për mbajtjen e saj, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 946/2013 më datën 21.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.